



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:172430

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05639204

CAP.nr.754/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit M.A, të cilën e përfaqëson i autorizuari H.K, avokat në Glllogoc, kundër debitorit SHSKUK-QKSUK në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore, për shkak të borxhit, në vlerë prej 935,08 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit M.A, av. H.K, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.582/20, i datës 27.02.2023, me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit M.A, av. H.K, nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr. 582/20, i datës 27.02.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr. 582/20, i datës 27.02.2023 e ka aprovuar prapësimin e debitorit SHKUK –QKUK Prishtinë, dhe është shfuqizuar urdhri përmbarimor, P.nr.380/20, i datës 14.05.2020 i lejuar nga përmbaruesi privat H.H në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditori përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që ankesën e kreditores ta aprovoj si të bazuar, te priset aktvendimi i atakuar dhe ta detyroj debitorin që t’ia paguaj kreditores borxhin sipas propozimit për përmbarim.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 14.05.2020, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv - Vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.12-48/2020, të datës 09.04.2020.

Përmbartuesi Privat H.H ka nxjerr urdhrin P.nr.380/20, të datës 14.05.2020, me të cilin e ka lejuar propozimin për përmbartim.

Pas pranimit të urdhrin, debitori ka paraqitur prapësim me propozim që të aprovohet prapësimi si i bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.582/20, i datës 27.02.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorës M.A, av, H.K, duke propozuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, të vërtetohet urdhri përmbartimor P.nr.380/20, të datës 14.05.2020 dhe të detyrohet debitori që kreditorës t'ia paguajë borxhin dhe shpenzimet e avokatit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se analizimit dhe vlerësimit të Urdhrit për përmbartim, ka gjetur se i njëjti, është lejuar mbi bazën e një dokumenti-akti administrativ i cili nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe nuk është i përshtatshëm për përmbartim andaj edhe gjeti se prapësimi është i bazuar. Me Nenin 27.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore është përcaktuar se *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se në këtë rast titull përmbartues është përdorë vendimi 01.Nr.12-48/2020, datë 09.04.2020, mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbartimit dhe është kërkuar që të realizohet kërkesa e përmbartur në të, ndërsa me asnjë veprim të mëvonshëm, duke përfshirë edhe nxjerrjen e vendimit të quajtur si korrigjues, nuk mundet zëvendësohet titulli përmbartues mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbartimit, siç është bërë përpjekje në këtë rast nga përmbartuesi privat.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura gjykata vlerëson se është dashur të vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi ngase në këtë rast nuk ka pasur kushte ligjore të iniciohet procedura e përmbartimit dhe të lejohet përmbartimi nga përmbartuesi privat, kjo pasi që vendimi administrativ

në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbartimore, nuk mund të konsiderohen titull përmbartues ashtu siç është përcaktuar me dispozitat nga nenet 21, 27 dhe 36 të LPP-së..

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe Gjykata ankimore i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e Apelit gjatë shikimit të shkresave të lëndës, vëren se dokumenti në bazë të së cilit është bërë propozimi për përmbartim është dokument përmbartues –vendimi administrativ i marrë nga Inspektorati i Punës, i cili parashihet si dokument përmbartues me nenin 22 par.1, nën par.1.2 të LPP-së ku përcaktohet se: ” 1. Dokumente përmbartuese janë: 1.2. vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia); ” Por, përkundër faktit se propozimi për përmbartim është bërë në bazë të dokumentit përmbartues, kjo Gjykatë gjen se dokumenti nuk është i përshtatshëm për përmbartim për faktin se nuk i përmban elementet e përcaktuara me dispozita ligjore për tu konsideruar si dokument përmbartimor.

Neni 27 i LPP-së, në mënyrë shprehimore parasheh se “dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bën dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim.

Nga shikimi i shkresave të lëndës, për këtë Gjykatë rezulton të provohet fakti se dokumenti përmbartimor –vendimi administrativ i Inspektoriatit të Punës, 01Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nënkupton se dokumenti në fjalë nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm për tu përmbartuar sepse është në kundërshtim me dispozitata e LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:172430
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05639204

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.754/2023, me datën 29.04.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj, d.v.